

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
NR 2803 REP
NR 747 KOL

ZYRA E NOTERISE
MALLKUCI - SADUSHI



KONTRATE SHITJE KUOTASH

Sot ne daten 13.03.1999 (nentedhjete e nente) perpara meje ARIANA MALLKUCI ,
Notere ne qytetin Tirane, me zyre ne Rr. " DURRESIT ", Pall. 11, u paraqiten
personalisht palet :

PALA SHITESE :

1. HAXHI YMERI i biri i Bilalit, lindur me 1932ne Paramithi, banues ne Tirane, me
zotesi te plote juridike per te vepruar, me pasaporte nr. 093912.

2. DILAVER YMERI , i biri i Haxhiut , lindur me 1961, banues ne Tirane, me zotesi
te plote per te vepruar, me identitet te njohur prej meje, me dokument nr.
093763.

BLERESE : MIRJANA KUKA, e bija e Haxhiut, lindur me 21.10.1964 dhe
banuese ne Tirane, me zotesi te plote per te vepruar, me dokument nr 0933873.

OBJEKTI: Trasferim nepermjet shitjes te kuotave te Shoqerise " DIPLOMAT
H.Y.", e regjistruar ne gjykate me vendimin Nr.6764, date 16.09.1993.

Pala shitesse Haxhi Ymeri dhe Dilaver Ymeri jane ortak te Shoqerise " DIPLOMAT
H.Y. ", shpk, me : Haxhi Ymeri 10 % te kuotave baraz me 35.100 USD dhe Dilaver
Ymeri me 90% te kuotave baras me 315.900 USD.

Kapital i kesaj shoqerie eshte nje godine me tre kate, Bar-Restorant-Hotel, me
siperfaqe ndertimore 926m2, e vendosur mbi nje truall me siperfaqe 900 m2, e
kufizuar : nga Lindja - Rr. " Muhamet Gjolllesha", Perendimi - rruga qe shkon ne
Institutin e Projektimit, Jugu- Instituti Projektimit dhe Veriu Shkolla " Vasil Shanto".

Prona eshte e regjistruar ne Zyren e Regjistrimit te Pasurive te Palujtshme, Hipoteka
Tirane, me nr. _____date____.05.1999, ne Zonen Kadastrale Nr. _____.

Kuotat e tyre ne kete shoqeri (kapital ne natyre) z.Haxhi Ymeri 10 % te kuotave baraz
me 35.100 USD dhe z. Dilaver Ymeri me 90% te kuotave baras me 315.900 USD
deklarojne se kane rene dakort t'ja shesin z. Mirjana Kuka duke u bere ortak e Vetme
e Shoqerise " DIPLOMAT H.Y." shpk, me 100 % te kuotave , baraz me 351.000
USD (dhe objektit te mesiperm) si dhe Administratore e Shoqerise.

Pala blerese Z. Mirjana Kuka deklarom se eshte dakort te bleje kuotat e mesiperme, 100% baraz me 351.000 USD (treqintepesedhjetenji) te cilat jane kapital ne natyre i shoqerise " DIPLOMAT H.Y.", objekti siperpershkruar, duke u likujduar menjehere jashte kesaj zyre.

Palet nuk kane me detyrime te tjera karshi njeri tjetrit.

Bleresja Mirjana Kuka deklarom se merr persiper bllokimin e objektit ne Hipoteke ne favor te Bankes se Kursimeve Tirane, deri ne shlyerjen e kredise nga z. Dilaver Ymeri ndaj kesaj banke dhe nuk njej pretendime nga te trete.

Paleve ju be e ditur se me noterimin e kesaj kontrate ortaket Haxhi Ymeri dhe Dilaver Ymeri largohen nga shoqeria " DIPLOMAT H.Y. " shpk, dhe ne vend te tyre ortake e vetme e Shoqerise , behet z. Mirjana Kuka, me 100 % te kuotave ose 351.000 USD.

Administrator behet Z. MIRJANA KUKA.

Kontrata u hartua nga une Noteri ne kater kopje te njejta nga te cilat nje kopje ruhet tek Noteri, nje kopje dorezohet ne Gjykate dhe dy kopjet e tjera i dorezohen paleve, ju lexua paleve me ze te larte dhe qarte te cilet e kuptuan permbajtjen e saj dhe meqenese ajo shpreh vullnetin e tyre te lire dhe te plote e nenshkruan ate perpara meje dhe une e vertetoj ate sipas ligjit.

SHITES

HAXHI YMERI

Haxhi Ymeri

DILAVER YMERI

Dilaver Ymeri



BLERES

MIRJANA KUKA

Mirjana Kuka

[Signature]